



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
KRYESIA

Tiranë, më 08.01.2018

Prot 7

Urdhër nr. 2, datë 08. 01. 2018

Për një ndryshim në nenin 13 "Përbërja e Jurisë", në rregulloren "Për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; për mënyrën e organizimit të konkurseve; për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre", aprovuar me urdhrin nr. 11 datë 6 tetor 2016 të Kryesisë së ASH-së

Drejtuar: Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike
Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike
Të gjithë akademikëve,
Sektorit të Bibliotekës dhe të botimeve Shkencore në ASH
Sektorit të Financës

Për shkak të ndryshimit të emërimit të disa institucioneve që kanë përfaqësues të tyre *ex officio* në përbërjen e jurisë së çmimeve vjetore shkencore kombëtare që organizohen dhe akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë;

Referuar nenit 13, pika 1 dhe pika 2, të rregullores së cituar më sipër për mënyrën e formimit dhe përbërjen e jurisë; si dhe nenit 17 të saj, për amendimet, me propozim të seksioneve shkencore:

URDHËROJ:

1. Anëtari përfaqësues i Ministrisë së Teknologjisë dhe të Informacionit, institucion që nuk ekziston më në strukturën e administratës shtetërore, zëvendësohet nga një anëtar përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
2. Në fund të nenit 13 pika 1 shtohet: *Anëtar - një përfaqësues i Akademisë së të Rinjve.*
3. Përbërja e Jurisë pas ndryshimeve është si më poshtë:

Neni 13

Përbërja e jurisë

1. Juria formohet me këtë përbërje:

Kryetar : Një përfaqësues i Kryesisë së ASH.

Anëtar : Një përfaqësues i Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike me titullin "Akademik".

Anëtar : Një përfaqësues i Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike me titullin "Akademik".

- Anëtar :** *Dy përfaqësues të seksioneve gjegjëse të Asamblesë së ASHSH.*
- Anëtar :** *Një përfaqësues i akademikëve mbi 75 vjeç.*
- Anëtar :** *Një përfaqësues i Agjencisë së Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit pranë Ministrisë së Arsimit.*
- Anëtar :** *Një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit.*
- Anëtar :** *Dy përfaqësues prej rrjetit të universiteteve shqiptare me titullin "Profesor"; gjegjësisht nga shkencat shoqërore dhe ato teknike-natyrore*
- Anëtar :** *Një përfaqësues i Komisionit Kombëtar të UNESCO-s pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.*
- Anëtar :** *Një përfaqësues i Komisionit Kombëtar të AIESEE.*
- Anëtar :** *Një përfaqësues i Akademisë së të Rinjve pranë Akademisë së Shkencave..*

4. Ngarkohet Këshilli Ekzekutiv, kryetarët e seksioneve dhe sektori i financës për zbatimin e këtij Urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Vasil S. TOLE

SEKRETAR SHKENCOR



The image shows a handwritten signature in blue ink that reads "Vasil S. Tole". Below the signature is a circular official stamp in blue ink. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top and "AKADEMIA E SHKENCAVE" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.